

Libeskind në Bukuresht¹

Prof. dr. Ger Duijzings

Më 15 maj 2013, gjatë njërës prej vizitave të mia të rregullta në Shtëpinë e Popullit, pjesë e punës në terren, m'u dha rasti të bëhem dëshmitar i një ceremonie interesante që ishte duke u zhvilluar në ndërtesën më ikonike të Bukureshtit: akordimin e një doktrature nderi yllit të arkitekturës botërore Daniel Libeskind, nga Universiteti i Arkitekturës dhe Urbanizmit "Ion Mincu". Ceremonia, një nga pikat kulmore të Kongresit Rumun të Arkitekturës dhe Dizajnit (ROCAD) të 2013-s, më zgjoi kureshtjen, ose më saktë mosbesimin: gati njëzetë e pesë vite pas rënies së socializmit, elita arkitekurore e Rumanisë zgjodhi pikërisht këtë ndërtesë (mbi çdonjëren nga godinat e pritshme akademike) për t'u mbledhur dhe për të nderuar një arkitekt, i cili njihet për angazhimin e tij me Holokaustin (dhe tragjedi bashkëkohore si sulmi terrorist i shtatorit të vitit 2001 në Shtetet e Bashkuara), si dhe për faktin se ai nuk ka hezitur t'i kundërvihet kolegëve të tij që kanë bashkëpunuar me regjime jodemokratike, si ai i Kinës. Në pritje që Libeskind të merrte fjalën, pyesja veten nëse ai do t'i referohej historisë së godinës, një nga ndërtesat autoritare më të mëdha dhe më famëkeqe të shekullit të njëzetë, apo nëse Libeskind do të heshtte për të mos ofenduar organizatorët.

1 Artikull i porositur nga Arhitekt (Bukuresht) me rastin e East Centric Architecture Triennale (Bukuresht, 10-27 tetor 2013). Publikuar online në: <http://www.arhitekt.com/english/2013/10/ger-duijzings-libeskind-in-bucharest/> dhe <http://www.east-centricarch.eu/critic-theory> (tetor 2013). Përkthyer nga anglisht-ja nga Jonida Gashi.

Si përfundim, Libeskind nuk e shmangu aspak çështjen por e adresoi atë në mënyrë diskrete, duke deklaruar në fillim të fjalës së tij se Bukureshti është një “qytet i bukur dhe fantastik”, por njëherazi një qytet “plot me histori dhe vuajtje njerëzore”. Me këto fjalë, ai i rikujtoi audiencës së tij rrezikun që i kanoset lirisë njerëzore nën regjime politike si ai i Nicolae Ceaușescu-t, që përdorin dhunën dhe denigrojnë lirinë e individit në emër të qëllimeve më të larta ideologjike.

Libeskind e cilësoi Shtëpinë e Popullit si mishërimin e arkitekturës së keqe: “një ndërtesë e krijuar nga diktatorët, për të impresionuar publikun, për të shtypur qeniet njerëzore, dhe për të krenuar një lloj bote ëndrrash të pushtetit”. Duke diskutuar rrugëtimin e tij nga muzika drejt arkitekturës, Libeskind përcolli pikëpamjet e tij mbi profesionin si “më muzikali ndër të gjitha artet”, si “një art i komunikimit me shpirtin njerëzor”, dhe si një formë narrative e rrëfimit të historive – histori që shpeshherë janë të një natyre sensitive dhe të vështira për t’u komunikuar me fjalë, por që mund të pasqyrohen nëpërmjet arkitekturës, nëpërmjet përdorimit të hapësirës, materialeve dhe dritës. Libeskind i përshkroi dizajnet e tij arkitekturore (si Muzeu i Hebrejve në Berlin dhe Masterplani i Ground Zero në New York) si një mënyrë për të “qëndruar mbi truallin e kujtesës”, duke i dhënë zë gojëve që janë heshtur dhe duke i dhënë vizibilitet eksperiencave që janë prezente në një qytet, por që jo gjithnjë janë të dukshme e jo gjithmonë bien në sy.

Dizajneri i versionit origjinal të Kullës së Lirisë (Freedom Tower), pjesë e Masterplanit të Ground Zero, e cila kap 541m lartësi dhe është godina më e lartë në SHBA, i foli audiencës së tij rumune mbi rëndësinë e asaj çka një godinë komunikon përtej madhësisë apo madhështisë së saj: një ndërtesë e vogël mund të komunikojë diçka shumë më të thellë se sa një ndërtesë e madhe që është fizikisht imponuese por e zhveshur nga çdo atribut njerëzor, duke iu referuar pikërisht godinës ku po mbante fjalën. Në fjalën e tij Libeskind preku edhe disa nga pikat e ngritura nga Bodgan Ghiu në tekstin e tij kuratorial trans(ap)parencies.

Pasi përcolli përçmimin e tij të thellë për vetitë depersonalizuuese dhe shpirtërisht boshe të godinave autoritare, ai nuk la pa përmendur as kontributet e ndryshme pozitive që arkitektura mund të japë për ecurinë e një shoqërie të hapur, qytetare, dhe demokratike, duke e vënë theksin tek kujtesa dhe komunikimi si dy elementët kyç të një arkitekture të hapur dhe të orientuar drejt demokratikes.

Por fakti se establishmenti arkitekturor rumun vendosi t'i akordojë një doktoratë nderi një arkitekti që njihet botërisht për trajtimin e traumave historike, nuk presupozon automatikisht se kjo elitë ndihet e trazuar nga fakti se kongresi i saj vjetor po zhvillohet (për të dytën herë) në ambientet e një ndërtese autoritare, e cila e mohon vizionin e Libeskind në mënyrë absolute. A ka mundësi që shumica prej tyre të ndiejë (akoma) një admiratë të fshehtë për godinën, si një nga arritjet e arkitekturës rumune? Apo mos vallë ata janë thjeshtë indiferentë ndaj vuajtjes dhe dhimbjes së shkaktuar prej saj? Kjo mbetet për t'u parë, por e vërteta është se në dizenjimin e Shtëpisë së Popullit morën pjesë qindra arkitektë rumunë. Mes tyre ka disa syresh që, në mënyrë të paskrupullt, nuk hezitojnë ta përmendin kontributin e dhënë nëpër CV-të e tyre. Ndërkaq, shumë pak kanë shprehur pendesë publike për përfshirjen e tyre në projekt.

Kështu pra, mendoj se është me vend të pyesim nëse Shtëpia e Popullit është vërtetë pjellë e diktatorit dhe gruas së tij, apo nëse në këtë "arritje" monstroze janë të implikuar edhe anëtarë të elitës arkitekture rumune, që e kanë zhvendosur pjesën e tyre të përgjegjësisë dhe bashkëfajësisë mbi supet e kryearkitektit Anca Petrescu (ashtu siç ekzekutuesit pretendojnë se po zbatojnë urdhrat e eprorëve). Cilado qoftë përgjigja, Shtëpia e Popullit mund të shihet si shembulli ekzemplar i asaj që një nga antropologët më në zë sot, Michael Herzfeld, e ka quajtur "spastrim hapësinor", duke bërë një analogji eksplicite me spastrimin etnik, dhe që konsiston në krijimin e hapësirave të gjëra publike të kontrolluara e të "purifikuara", mbi të cilat qeveria ushtron një prezencë komanduese, duke e përjashtuar popullatën në proces e sipër.²

2 Herzfeld, Michael. "Spatial cleansing: monumental vacuity and the idea of the West". *Journal of Material Culture*. Vëll. 11, nr 1-2. Londër, 2006, f. 127-

Gjatë dy dekadave të fundit kjo ndërtesë autoritare është “zbutur” disi, dhe shumë shpejt do të ketë antidotën e saj ideologjike në formën e një tjetër Shtëpie të Popullit po aq pompoze dhe të ekzagjeruar, Katedralen Ortodokse të Shpëtimit Kombëtar e cila po ndërtohet në truallin e Casa Poporului. Shtëpia e Popullit i është nënshtruar një lloj konvertimi dhe fragmentarizimi post-socialist dhe, sot që flasim, ajo strehon një sërë institucionesh kombëtare, si Parlamentin Rumun (Senatin dhe Dhomën e Deputetëve), Gjykatën Kushtetuese, Muzeun Kombëtar të Artit Bashkëkohor, si dhe zyrat qendrore të Shërbimit të Gardës dhe Mbrojtjes (SPP), një forcë speciale elitë që u krijua në vitin 1990 nga Presidenti Iliescu për t’u siguruar vende pune ish-anëtarëve të Securitate-s. Është pikërisht SPP-ja e cila garanton tanimë “unitetin” e Shtëpisë së Popullit (që sot njihet edhe me emrin Pallati i Parlamentit), duke mbajtur një kordon të rreptë sigurie përgjatë perimetrit të ndërtesës. SPP-ja e “zotëron” Shtëpinë e Popullit më shumë se çdo organizatë tjetër, duke kontrolluar prurjet e njerëzve në hyrje dhe në dalje të godinës. Rrjedhimisht, Shtëpia e Popullit, pavarësisht funksionit të saj të ri publik, mbetet një “fortesë” më një nivel të lartë sigurie, e pa aksesueshme, dhe një qendër e pamposhtur pushteti.

Ndërtesa i ka “hapur dyert” për një sërë evenimentesh, si konferenca akademike të rëndësishme ndërkombëtare, panairë komerciale, dhe edicionet e përvitshme të Ballos Vjeneze që organizohet për elitën lokale. Ndërtesa është bërë gjithashtu sfondi i spektakleve të ndryshme, si gara makinash apo koncerte të muzikës rrok, të cilat organizohen rregullisht në Sheshin e Kushtetutës përpara saj. Të premtëve mbrëma, kjo hapësirë e gjerë gjysmë-rrethore transformohet në një ambient takimesh informale mes anëtarëve të klubeve automobilistike të Seat, BMW, Dacia, Škoda etj., fanatikëve të automobilistikës, si dhe për festa fejese.

Të gjitha këto aktivitete që zhvillohen në brendësi të godinës dhe në sheshin përpara saj, e bëjnë atë të duket disi më pak kërcënuese dhe ca më tepër njerëzore e, megjithatë, ato nuk kanë arritur ta transformojnë ndërtesën në një “Shtëpi të Popullit” në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.

Shpeshherë këto hapësira janë të aksesueshme për një audiencë të kufizuar, pra vetëm për ata që mund të përballojnë çmimet e larta të biletave, gjë që e kam vënë re sidomos në koncertet e mëdha të muzikës rrok. Në këto raste Sheshi i Kushtetutës mbyllet në mënyrë hermetike nga xhandarmëria, pjesëtarët e audiencës vihen në radhë në hyrje të sheshit, ndërkohë që të pastrehët dhe të moshuarit rrëmojnë rreth e përqark për të gjetur ushqim dhe shishe plastike, kurse të punësuarit në Shtëpinë e Popullit i shohin këto koncerte falas nga ballkonet e ndërtesës. ROCAD 2013 pati një organizim të ngjashëm, ku biletat normale kushtonin €150, ndërkohë që kishte edhe zona VIP për ata që ishin të gatshëm të paguanin më shumë.

Kështu pra, një mendje më skeptike do ta karakterizonte Shtëpinë e Popullit sot si një simbol të pasanikëve dhe të privilegjuarve. Ajo përdoret kryesisht nga elita politike e Rumanisë, të cilët mbrohen nga forcat speciale. Siç shkruan një kritik, zhvendosja e parlamentit në ambientet e këtij simboli arrogant dhe molepsës të autoritarizmit mund të mos ketë qenë vendimi më i zgjuar: “Ekziston rreziku që kjo godinë t’iu ketë futur në kokë përfaqësuesve të zgjedhur idenë se pushteti që iu është akorduar nuk është një mandat popullor, por një pushtet që ata mund ta administrojnë kur dhe si ta shohin të udhës.” Ndërtimi luksoz, shpërdorimi i fondeve publike dhe sfondi kitsch, të gjitha këto duket se inkurajojnë megalomaninë e klasës politike, përbuzjen totale për nevojat reale të elektoratit të tyre dhe iluzionin e të qenit pjesë e një “elite” të paprekshme.³ Protestat politike që zhvillohen në mënyrë sporadike jashtë murit rrethues duket sikur, në mënyrë të pashmangshme, bien në vesh të shurdhër, pasi ato duken të kota në mos qesharake përballë kësaj godine gjigante.

Hapësira, siç këmbëngulte Michel Foucault, luan një rol instrumental në ushtrimin e pushtetit, duke regjimentuar jetën e përditshme, duke kontrolluar praktikat hapësinore, dhe duke krijuar trupa “të butë”. Arkitektura socialiste dhe praktikat socialiste të planifikimit urban përbëjnë një rast interesant në këtë debat, pasi ato prodhuan një trashëgimi materiale

3 Pandelescu, Andrei. The House of the People. The end, in marble. Bukuresht, Compania, 2009.

ndërtesash dhe peizazhesh që tanimë janë pjesë e një të kaluarë, e cila, në tërësinë e saj, është mohuar. Pyetja është se deri në çfarë mase këto peizazhe e mbartin akoma fuqinë për të regjimentuar jetën e përditshme në logjikën e funksionit të tyre origjinal?

Foucault, që siç thamë më lart nënvijëzon instrumentalizimin politik të konfigurimeve hapësinore, do të këmbëngulte se kur kemi të bëjmë me forma specifike arkitekture, ato jo domosdoshmërisht mbartin një domethënie politike të pandryshueshme, që nënkupton ekzistencën e një potenciali transformues të siteve dhe hapësirave pavarësisht funksionit të tyre të mëparshëm.⁴ Padyshim që në parim ne mund ta pranojmë ekzistencën e një potenciali të tillë, e megjithatë, në rastin e Shtëpisë së Popullit, të paktën një pjesë e funksionit të saj të mëparshëm socialist duket se vazhdon të gjallojë, duke shfaqur disa vijimësi me të kaluarën, pavarësisht konvertimit dhe “demokratizimit” të saj. Kështu pra, për disa individë, Shtëpia e Popullit mbetet një godinë totalitare, e stërmadhe, agresive dhe paranojake. Të tjerë shohin tek ajo imazhin e panoptikonit të Benatham-it: një godinë fuqiplotë dhe e padepërtueshme që ngrihet mbi qytetin, e rrethuar nga një rrip toke të zbrazët, përqark tij një mur rrethues tri-kilometërs, me qindra dritare që personifikojnë “syrin” e gjithëpranishëm që vëzhgon nga lart.⁵

Aplikimi i këtyre nocioneve të qeverisjes hapësinore dhe i imazhit të panoptikonit paraqet disa problematika, për arsyen e thjeshtë se shtypa kryesore pas ndërtimit të Shtëpisë së Popullit, regjimi socialist i Ceaușescu-t, u përmbys përpara se projekti të përfundonte. Në kohën e Revolucionit Rumun (1989), Shtëpia e Popullit ishte një “qytet fantazmë”, plot me struktura boshe, të cilat ishin ende në një fazë fillestare ndërtimi. Mjafton të shohësh xhirimet e papërpunuara në veprën e artistit bashkëkohor rumun Ion Grigorescu, Vitan Ceaușescu: the crooked axes of the Civic Centre (1993-1994), ku tregohet një djerrinë e stërmadhe karabinash betoni e vinçash, trase të përbaltura që vende-vende janë mbuluar me çakëll dhe,

4 Rabinow, Paul. “Ordonnance, discipline, regulation: some reflections on urbanism”. *The Anthropology of space and place: locating culture*. Malden, Blackwell, 2003, f. 353-62.

5 Salecl, Renata. “The state as a work of art. The trauma of Ceaușescu’s Disneyland”. *Architecture and revolution: contemporary perspectives on Central and Eastern Europe*. Londër, Routledge, 1999, f. 92-111.

tek-tuk ndonjë rrugë, ku të bie në sy numri i vogël i kalimtarëve. Ajo nuk ishte pra (akoma) një hapësirë panoptike, por më tepër një hapësirë e zbrazur nga njerëzit, e konceptuar si një aks ceremonial për parakalimin e paradave dhe për qarkullimin e makinave të enturazhit të Ceaușescu-t.

Besoj se thelbi i teknologjisë së pushtetit të Ceaușescu-t ka të bëjë jo dhe aq me format apo konfigurimet e përfunduara hapësinore, se sa me procesin e shembjes dhe të ndërtimit në shkallë masive. Në rastin e Shtëpisë së Popullit, Ceaușescu ushtroi një kontroll substancial mbi këtë proces nëpërmjet ndërhyrjeve personale dhe dekretive shtetërore, duke përfshirë këtu rrafshimin e siteve ku do të ndërtohej. Ai fshiu disa monumente kulture m'u përpara syve të qytetarëve të Bukureshtit, duke i reduktuar ata në spektatorë të pafuqishëm, të pamundur për të bërë gjë tjetër (të rezistonin) veçse të kundronin sa të hipnotizuar, aq edhe të lemerisur.

Procesi i shembjeve dhe ndërtimeve ishte prova përfundimtare e fuqisë së tij: për sa kohë që askush nuk mund t'i ndalonte ndërhyrjet e tij brutale dhe megalomane, Ceaușescu ndihej i sigurt dhe i pamposhtshëm. Zakoni i tij për të devijuar nga vizatimet arkitekturore origjinale, duke i modifikuar ato pambarimisht, përputhet me modelin ku instrumenti kryesor i kontrollit politik, në formën e një vazhde të pasosur instruksionesh shpeshherë tekanjoze nga diktatori dhe bashkëshortja e tij, që kishte si synim final bindjen dhe nënshtrimin e subjekteve dhe përforcimin e hierarkisë, është pikërisht procesi dhe jo rezultati final.

Siç ka argumentuar Ștefan Ghenciulescu, Shtëpia e Popullit është bërë objekti i një transferimi pervers të identitetit: ndonëse e krijuar nga Ceaușescu, shtëpia është "e bukur" pasi ajo u ndërtua "falë sakrificave tona".⁶ Ajo është shndërruar gradualisht në një simbol të arritjeve kombëtare: e ndërtuar nga rumunët dhe vetëm me materiale rumune; e admiruar nga vizitorët e huaj që kanë dëshirë të shohin diçka ndryshe; kurse ata që ndihen thellësisht të trazuar dhe revoltuar

6 Ghenciulescu, Ștefan. "The House of the People and matchboxes for people to live in. Socialist architecture in Romania after 1989: perceptions, transformations, continuities". *Colloquia: Journal of Central European History*, nr.18. Cluj-Napoca, 2011, f. 150-61.

prej saj përfaqësojnë një minoritet të vogël (të cilit i përket Libeskind). Shtëpia e Popullit u kujton rumunëve historinë e tyre, dhe përfaqëson një pikë të qëndrueshme referimi në raport me transformimet e qytetit përreth saj. Megjithatë, duhet të shpresojmë që një ditë kjo ndërtesë autoritare vërtetë do të zhbëhet, dhe jo vetëm duke e “zbutur” bishën, por edhe nëpërmjet angazhimit kritik me dhimbjen dhe vuajtjen që ajo ka shkaktuar dhe trashëgimitë e vijimësitë që ka lënë pas. Kjo larje hesapësh me të kaluarën është dhe do duhej të ishte në të njëjtën kohë një reflektim bashkëkohor mbi të këqijat e shoqërisë rumune. Muri që ndan Pallatin e Parlamentit dhe qytetarët duhet të shembet, siç deklaroi së fundmi Presidenti i Dhomës së Deputetëve (duke pozuar para kamerave me një vare), por hapja e dyerve kryesore të ndërtesës dhe zburimi i hapësirës së gjelbër para tyre nuk mjafton për ta arritur këtë. Ajo që nevojitet është që ndërtesa të kthehet nga brenda-jashtë, në këndvështrimin hapësinor, në këndvështrimin historik si dhe në atë politik.